



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.1054/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Gentianë Hoti nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1054/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Gentianë Hoti, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, në komunën e Malishevës, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimin me nr.3036A/01R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1054/2021 të paraqitur nga Gentianë Hoti, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Nisma Social Demokrate, me të cilën pretendon se në qendrat e votimit 3036A/01R, në Turjakë, siç thekson ka shumë dëshmi që është votuar numri 12 dhe lista e Nismës Social Demokrate me numër 113, dhe se këto vota nuk figurojnë askund.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Gentianë Hoti, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Nisma Social Demokrate, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet 3036A/01R.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme, për faktin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi, formular apo ndonjë deklaratë që do të dëshmonte se pretendimet e tije për pa rregullsi në vendvotimet përkatëse janë të bazuara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.1054/2021 më datën 05.11.2021**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.